




REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK	Nr. Prot. 03-02/3781/17
Dep. 02	Prot. No. 16.11.2017
Nr. Titull	Data
Proj. sh. anika	Datum
Nr. pages	Date



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.11.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2473/17, për z. Sherif Sejdiu, Kryesues i Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Sh.A - Prishtinë, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Sherif Sejdiu, Kryesues i Bordit të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Sh.A - Prishtinë, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar), në bizneset private N.T.Sh "Didole" dhe Sh.P.K, "Kabashi - Sh" është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimi të kësaj shkrese, është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Sejdiu është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit.

Prandaj, nga zyrtari i lartë është kërkuar të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në bizneset private, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë është deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmerr veprime për shmangien e gjendjes së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/3626/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në bizneset private të cekura më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

